

rike të kohës dhe të faktorëve që ndikuan në krijimin e këngëve, në fund, mund të pohojmë lirisht se vepra e dr Fazli Sylës „Poezia popullore shqiptare e kaçakëve” është një kontribut i vlefshëm shkencor që ndriçon në mënyrë të shumanshme

problematikën e këngëve të kaçakëve dhe të vlerave të tyre ideoestetike dhe duhet të shërbejë si përvojë pozitive për thellimin e mëtejshëm të studimeve kushtuar poezisë popullore shqiptare me tematikë historike.

SADRI FETIU

NINULLA, Instituti Albanologjik i Prishtinës, përgatitur nga Sadri Fetiu, Prishtine 1982, f. 237.

Vëllimi i tetë me krijimtari letrare popullore, Ninulla, të cilin e botoi Instituti Albanologjik i Prishtinës, është vëllimi i asaj pjese të poezisë që jeton e krijohet edhe sot. Është, pra, ajo poezi që bën jetë aktive me funksion të shquar në jetën dhe traditën e popullit tonë.

Ninulla nuk parashtron kërkesa që të dëgjohet, të pëlqehet dhe, më në fund, të refuzohet nga auditoriumi i gjerë, por i dedikohet foshnjës që akoma s'është aftësuar ta kuptojë këngën. Ninullën nuk e përcjellin instrumentet dhe meloditë vokale. Frymëzimi krijues i ninullës është „shtalb”, ai nuk këndon as për subjektet e dashurisë, as për personazhe të historisë. Por, me gjithatë, duhet të konstatohet se ninullat kanë vlera stabile artistike, përmbajnë porosinë etike e artistike dhe përbëjnë një zhanër të pasur brenda poezisë popullore lirike. Në melodinë e improvizuar të nënës, melodi që ngjan fort në recitim të zëshëm artistik, sepse harmonizohet me krismën e djepit, ninulla ka vazhduar të krijohet dhe është bërë fond i pasur i poezisë së llojit të vet që trajtojnë aspekte të shumta të jetës, të etnosit të popullit dhe, njësoj sikurse gjuha, janë njësi kombëtare.

Këngët e djepit si lloj i poezisë lirike jo vetëm me përmbajtjen, por edhe me praninë e tyre hapësinore e kohore, me aktualitetin shoqëror, kanë ruajtur përherë freskinë artistike. Në këtë mënyrë ato i kanë ikur monotonisë, kanë përmbushur misionin shoqëror e artistik krahas me dinamizmin e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik dhe kultural.

Ky lloj i poezisë, sikurse edhe disal loje të tjera, mbështet në parimin

e improvizimit. Ninulla ndjek përsosjen e ritmit, fjalët e bukura dhe dëshirat e vazhdueshme i shtojnë këtij ritmi dinamikën, e cila e mban të zgjuar kureshtjen e vlerësuesit. Nga ky aspekt, melodia e ninullës, gjatë interpretimit, bën që ndjenjat të derdhen spontanisht mbi atë krismën e djepit, duke i dhënë depërtim të fuqishëm ndjenjës së amës, e cila përtrin vatrën me njomëza.

Prandaj, gjithsesi duhet të konstatohet se kënga e parë, kënga që nis me lindjen, ndërthur në vete elemente të llojeve të tjera të poezisë popullore lirike. Kjo këngë është pikëfillimi i perspektivës së njeriut, prej ku me sy të prindit vështrohet me kujdes, dashuri, me dëshirë të pasosur për shëndet të mirë të fëmijës, për jetë të lumtur, për martesë me fat, për karakter të përsosur, për burrëri të rrallë, ose, nëse fëmija është femër — për jetë të çiltër e të dëlirë gruaje. Prej këtij pikëllimi projektohet, natyrisht, me anë të imagjinatës, ardhmëria e familjes, e fisit — ardhmëria e popullit.

Vizioni si mjet i poetizimit, me anë të të cilit poezia shton vlerat komunikuese ndërmjet periudhave me distancë të dukshme kohore dhe vë lidhjet jetësore midis brezëve, është pajisja kryesore e ninullave, si poezi e parë, më e ngrohtë dhe më afër njeriut e, mbi të gjitha, si poezi e krijuar nga prindi që s'di të kursyer për fëmijën e vet.

Virtytet e njeriut që bazohen në traditën kanunore, por në ninulla, nxisin frymëzime edhe për llojet e tjera të këngëve popullore.

Ninullat janë këngë të vjetra. Ato që nga totemi e këndeje ruajnë në vete gjurmë besimesh të ndryshme, ku-

rse elementet e lashtësisë zakonore e mitologjike kombëtare na shfaqen herë pas here:

O, o, o, pa t'përkund nana,
O, o, o, t'kndan nana si zana:

(F. 35)

Elementet e lashtësisë, të cilat paraqiten drejtpërdrejt ose tërthorazi në këngët e djepit, janë gjithnjë dëshmi se këngët e djepit janë shquar më tepër në interpretimin e nënave e më rrallë në interpretimin e motrave ose të gjysheve. Për lashtësinë e ninullave, pos materialit që ruajnë ato vetë, të dhëna na afrojnë edhe etnologjia, religjioni, mitologjia e shkenca e tjera. Disa nga këto elemente janë ruajtur te stolisjet e djepit, te zbukurimi i pjesëve të veshjes, te stolisja e flokëve që përdoren kurdoherë me domethënie të caktuar, siç është tufa shumëngjyrëshe, guri i mësyshit, procesi i fikjes së gazeve, i shkrirjes së plumbit etj.

Në ninulla nëna i jep rëndësi përmbajtjes, domethënies së çdo fjale veç e veç, të vargut e të strofës si pjesë të këngës dhe, këngës si vepër e saj. Prandaj këngët e djepit nuk janë krijuar me shprehje të thjeshta, po ato janë të drejtpërdrejta, figurative dhe përmbajnë mjaft fakte poetizuese: vizionin, magjinë, dëshirën, mallkimin, monologun, dialogun, epitetin, hiperbolën, krahasimin, simbolin, personifikimin, e një numër të konsiderueshëm mjetesh artistike.

Mjetet poetizuese të ninullave, në aspektin e ardhmërisë, ashtu si e projekton më së miri nëna me përvojën e saj njohëse, luajnë rol të shumfishtë, sepse çojnë përpara dëshirën e njerëzimit dhe synojnë progresin shoqëror.

Por, duhet të themi këtu, për shkak specifikave të veçanta të këtyre këngëve, krahasimet, personifikimet, simbolet e figurat e tjera, më në fund edhe trokitjen onomatopeike të djepit, janë model gjithashtu i veçantë figurash që kanë rol specifik në poezinë, të cilën për herë të parë e zë veshi i njeriut.

Kjo poezi është interesante edhe për nga numri i krijuesve-interpretuesve, i cili është po ashtu i madh. Këtë këngë nuk e krijojnë këngëta-

rë profesionalë e gjysmë profesionalë, por e krijojnë, madje edhe e interpretojnë të gjitha ato femra me të folur normal, që kanë fatin të bëhen nëna. Një numër kaq i madh krijuesesh-interpretuesesh doemos dëshmon për kualitetin e këngëve të djepit, për vlerat artistike që i shtojnë këto fondit të përgjithshëm të lirikës popullore shqipe.

Parathënia e këtij vëllimi të ninullave, e shkruar me përgatitje e kujdes nga Sadri Fetiu, i shquan vlerat e këtij lloji të poezisë dhe sjell një sërë konstatimesh, me të cilat duhet të merren studiuesit e ardhshëm. Ai, pa dyshim, ka vepruar drejt duke u mbështetur, sa i takon radhitjes, vlerësimeve për anën poetike dhe për gjenezën e këtyre këngëve, në dy burime: në rezultatet pozitive të studiuesve të mëparshëm rreth ninullave dhe në vetë ninullat si material i dorës së parë, si faktografi artistike. Ky qëndrim i drejtë i përpiluesit të blenit të ninullave jep mundësi për supozime dhe definicione objektive sa i përket poezisë së këtij zhanri.

Si lloj i poezisë, në krahasim me zhanret e tjera, ninulla është studiuar pak. Ky vëllim që ka 352 këngë, në botimet tona në gjuhën shqipe është më i ploti, sepse, duke përfshirë këngët e shumë trevave, jep mundësi për studime solide dhe përfundime të sigurta për këtë pjesë të lirikës sonë popullore.

Si cikël të parë, e njëherazi mund të thuhet edhe ceremonial të parë, Sadri Fetiu ka radhitur *Këngët e lindjes dhe të përgimit*, ndërsa në ciklin e dytë radhit *Ninullat*, kurse në të tretin *Këngët për ecjen dhe veprimet e para të foshnjeve*.

Këngët e ciklit të parë interpretohen me përcjellje të deficit. Ato u kushtohen fëmijëve dhe manifestojnë gëzimin e familjes e të farefisit për lindjen e djalit. Me titujt që kumtojnë qëllimin e këngës, me meloditë e këngëve, me instrumentet që i përcjellin, këto këngë krijojnë një atmosferë dasme. Vërtet, ky është një lloj gazmendi, një lloj dasme, por, si thotë populli: „për të lemin e jo për të blemin”. Gjithashtu, mund të themi se është mirë që ky cikël zë vend këtu, me pak këngë, por me simbolikë të denjë për ardhjen e fëmijës, përkatësisht të djalit në jetë. Cikli

do të ishte shumë më i pasur sikur t'i këndohej dendur, sikurse edhe djalit, lindjes së vajzës, por kjo mund të jetë rrjedhim i ndryshimit të stave shoqërore, me mbizotërimin e patriarkatit mbi matriarkatin.

Si konstatim pasojnë, pra, dy të metat e ciklit, që s'janë dobësi e përpiluesit: e para, janë mbledhur e ruajtur pak këngë të lindjes dhe të përgimit në përgjithësi dhe, e dyta, s'janë ruajtur, ndoshta edhe s'janë krijuar fare, këngët e tilla që t'u këndohen vajzave. Mungesa tjetër, mjaft e dukshme, është se këto kanë shtrirje të kufizuar gjeografike. E tërë kjo flet për zbehjen e madhe dhe, ndoshta, zhdukjen e këtyre këngëve, për shkak të lënies pas dore të ceremonialit të lindjes dhe të përgimit në shumë treva.

Sa u përket ninullave, të cilat përpiluesi i ka studiuar mjaft hollësisht, vlen të theksohet se në të kënduarit e djepit, në idealizimin e rolit të tij, në epitetet e shumta që i jepen, ai gati-gati identifikohet me vetë fëmijën. Djepi në krijimin imagjnativ të këtij lloji të poezisë ngrihet në shkallën e kultit. Djepi është shtrati i qetësisë, vendi i rritës së foshnjës, po nëpërmjet tij parashihet të realizohen edhe synime të tjera që e shoqërojnë fëmijën në rrugën e fatit: martesë, pasuria, pozita shoqërore, fama etj.:

*Nina nana n'gjep të hekrit,
Ti u bafsh gjalë i fakultetit! (F. 55)*

Respekti gati shenjtëror që i bëhet djepit dhe ruajtjes së tij, ka bërë që me një djep të rriten dy-tri brezni. Më në fund, djepi, si simbol i poezisë popullore dhe asaj të shkruar, në përgjithësi, ka kuptime të thella e të shumta: si vendbanim i një fisi, i një populli, si ambient ku rritet e formohet njeriu me të gjitha tiparet e burrit të traditës, vend i lindjes, i formimit, i afirmimit të gjeniut etj.

Aspektet e veprimit të njeriut në jetë, ato që s'është aftësuar t'i punojë foshnja, madje nuk dihet se a do t'i punojë ndonjëherë, trajtohen gjerësisht brenda kufijve të imagjnatës së nënës, sepse ato janë të domosdoshme: puna për të siguruar ekzistencën, martesë për të siguruar vazhdimësinë e fisit, pleqërimi për

të siguruar jetën e qetë, lufta për t'u mbrojtur etj. Të gjitha këto trajtohen nëpërmjet personazheve, të cilat i njih historia, nëpërmjet gradave që i cakton rendi shoqëror dhe në terrenet e njohura e të identifikuar gjeografikisht si krahina, qytete etj.

Në aspektin e shprehjes së dëshirave ninullat konkretizohen aq shumë sa mund të mendojë ndokush se e kanë lëshuar rrugën e krijimit artistik, duke iu nënshtruar plotësisht kërkesave konkrete. Duhet të dihet e vërteta se mënyra e të kënduarit të tillë është traditë e këngëve familjare, ku aktualizohen gjërat më të njohura: fshatrat, qytetet, krahinat, figurat historike dhe, në këtë drejtim, aktualizohen ngjarje të reja dhe dëshirat që të krijohet lidhja me të parat.

Ninullat akumulojnë mbi bazën krijuese poetike dhe mbi disa rregullsi të traditës, gjithashtu, krijuese: shijen për të bukurën dhe vetë bukurinë, dëshirën për madhërinë dhe të madhërimin, gjithnjë sipas konceptit popullor. Kjo poezi në përmbajtjen e saj i ka eliminuar mundësitë që të shprehet pikëllimi, nostalgjia dhe ndjenja të tjera si ngarkesa shpirtërore. Duhet të konstatohet se kjo poezi nuk e kultivon as humorin. Ninullat, sidomos sa i takon përmbajtjes dhe porosisë për ardhmëri, trajtojnë kryesisht çështje serioze. Kjo këngë u jep hov ndjenjave dhe fantazisë fort dhe larg, duke synuar periudha që vijnë pas dekadash.

Profesionet dhe aktualiteti i tyre me anë të të cilave sigurohet jeta më e mirë, janë trajtuar në mënyrë të veçantë në ninulla. Njëpërmjet tyre shihet aftësia njohëse e krijueseve, qëndrimi i tyre ndaj jetës dhe ndaj ligjeve të saj-largpamësia e tyre për ardhmëri. Kemi profesione të vjetra dhe të reja, të cilat këtu janë trajtuar e ngulitur në atë masë sa krijueset kanë ditur e kanë pasur simpati për to, sipas shkallës e shmangies nga kornizat e konservatorizmit, nga varësia e të mirave të këtyre profesioneve, si dikur nga blegtoaria dhe nga bujqësia.

Duhet thënë edhe kjo: ninullat një bagazh të madh të pasurisë artistike e kanë të përbashkët me këngët, përkatësisht me zhanret e tjera të poezisë popullore, të cilat po t'i numë-

ronim në mënyrë statike, nuk na duken si elemente të poetizimit, siç janë, mençuria, trimëria, gradat, ngjashmëritë me heronjtë, identifikimi me qeniet mitologjike e religjioze etj. Por, prej këndej aktivizohen heronjtë që nga kohë e Skënderbeut e deri te Lufta Nacionalçlirimtare:

*Nina nana, djal'i zoti,
Ti m'u bafsh si Kastrioti,
Kastrioti, Lekë Dukagjini,
Ti m'u bafsh djalë ma trimi!*

Ose

*Mori xhum, xhi shotejtish,
Ene gjalin t'u na rrejtish,
T'u na rrejtish, na bajsh t'madh,
E ka nana partizan.
Partizan-o, të liftojsh,
Vendin tonë ta çlirojsh!*

(F. 75)

Në ninulla fëmija mësohet ta çmojë, ta ruajë dhe ta kultivojë gjithë atë që është pozitive në traditën kombëtare, si edhe ta shtojë fisin kryesisht me meshkuj, që të ndihet një siguri më e madhe jo vetëm për shtëpinë që rrit foshnjën, por edhe për rrethinën. Këto detyra ia thotë e ëma nëpërmjet këngës duke ia përcjellë si amanet, që është trashëguar brez pas brezi. Në këtë drejtim konstatohet qartë se në ninulla trajtohen aspekte të ndryshme, të shumta të jetës, sepse ajo është kënga më besnike që i transmeton porositë e traditës me optimizëm për ardhmërinë e lumtur të popullit.

Cikli i tretë *Këngë për ecjen dhe veprimet e para të foshnjës* është, për nga numri i këngëve, i ngjashëm me ciklin e parë *Këngë të lindjes dhe të përgimit*. Natyrisht se përmbajtja e këtyre këngëve dallohet nga ato të ninullave, edhe pse këto janë të lidhura ngushtë me veprimet e para të foshnjeve. Ato interpretohen në të njëjtën mënyrë, por me ritëm më dinamik, që e shquan mënyrën e melodisë së improvizuar — të recitimit.

E pohuam edhe më lart se ninulla krijohet në mënyrë të improvizimit, por ajo i ka edhe vendet e përsëritshme, formulat e veta, siç i kanë edhe këngët e tjera. I këtillë është sidomos vargu i parë që fillon me: „Nina nana, nana djalin”, ose „Ti m'i

gafsh...!”, ose „ti m'u bafsh-o...!” „Vargje e gjymës vargje formulative kanë edhe këngët epike legjendare, këngët erotike e këngët e tjera.

Fjalitë dëshirore, në mënyrën e tyre dhe për efekte të caktuara, i kanë të gjitha llojet e poezisë popullore, mirëpo kjo formë e përsëritur shpesh në ninulla tregon se ato janë pjesë e traditës krijuese dhe përfshihen në poetikën e përgjithshme të lirikës popullore.

Në disa këngë mungojnë vargjet tradicionale „Nina nana...” etj., nuk përmendet gjumi, por ritmi i tyre dhe struktura e lirikës familjare në përgjithësi, bëjnë që ato të konsiderohen ninulla. Të tilla janë në këtë vëllim këngët 199, 244, 300, 303, 304, 305 e ndonjë tjetër, të cilat, në lexim të parë, mund të shkaktojnë dyshim në përkatësinë e llojit.

Ninullat si këngë të improvizuara të poezisë popullore shquhen për vlerën artistike, për strukturën e vargut, për organizmin strofik, për rimën e pasur, për asonancën dhe për figuracionin. Studimi më i thelluar i ninullave në aspektin figurativ, në aspektin sociologjik e etnologjik, e pastaj studimi për zanafillën e tyre e të tjera, do t'i shquajë akoma vlerat e ninullave si poezi të një zhanri të pasur, si krijime imagjinative që *kommunikojnë me fjalën si mjet kryesor*. Komunikimi i tyre është i kuptueshëm dhe spontan, i rrjedhshëm dhe i drejtpërdrejtë, prandaj ato kanë krijuar stil të veçantë e karakteristik për llojin e tillë të këngës. Figurat janë të përdorura me maturi dhe nëpërmjet tyre diktohet femra-krijuese: natyra e ndjeshmërisë, kujdesi amëror, butësia dhe ëmbëlsia e shprehjes së amësisë:

*Ç'po i këndon djali djepit
Si bylbyli në rrem të plepit* (F. 45)

Prandaj nëna, atë që nuk e thotë me anë të krahasimit, epitetit, metaforës etj., e kompenson me anë të apostrofimit dhe të simbolikës. Në asnjë lloj tjetër të poezisë nëna-shtëpiake nuk ka mundur ta japë më të ndritshme ardhmërinë sesa në ninulla. Prandaj këtë lloj kënge mund ta konsiderojmë simbolikë dhe himn që e do dhe e këndon zemra e saj.

RRUSTEM BERISHA